UDHËZIM
Nr. 25, datë 1.8.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 30, DATË 12.9.2018, "PËR NUMRIN E NXËNËSVE PËR KLASË DHE NORMAT E PUNËS MËSIMORE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë dhe të shkronjës "d", të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/12, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 30, datë 12.9.2018, "Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar", të ndryshuar, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Pas pikës 2, të shkronjës "B", të kreut II, shtohet fjalia:

"Në klasat 1–9 të pakicave kombëtare mësimi zhvillohet në klasa të veçanta, pavarësisht numrit të nxënësve për klasë.".

b) Fjalia e fundit e shkronjës "D" në kreun II ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Nëndrejtori/nëndrejtorët ngarkohen për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë.".

c) Fjalia e fundit e shkronjës "C" në kreun III ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Nëndrejtori/nëndrejtorët ngarkohen për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, kur shkolla nuk ka sekretar.".

ç) Pika 2 e shkronjës "B" në kreun IV ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Kur numri i nxënësve është mbi 400, emërohen tre nëndrejtorë.".

d) Pika 3 e shkronjës "B" në kreun IV, ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Kur numri i nxënësve është nën 400, në shkollat e baletit emërohet një nëndrejtor.".

dh) Pikat 3 dhe 4 të shkronjës "C" në kreun IV ndryshohen me këtë përmbajtje:

Dega "Muzikë":

i. Mësuesit e specialiteteve muzikore: 18 orë në javë;

ii. Mësuesit e specialitetit pianist shoqërues: 24–26 orë në javë;

iii. Mësuesit e lëndëve teorike muzikore: 18–20 orë në javë;

iv. Grupet e lëndëve teoriko-praktike formohen me 6 nxënës.

Dega "Arte figurative":

i. Mësuesit e specialiteteve: 16–18 orë në javë (8+8)/(9 + 9);

ii. Mësuesit e lëndëve teorike artistike: 16–18 orë në javë;

iii. Grupet për lëndët pikturë/vizatim: 4–6 nxënës për grup;

iv. Grupet për lëndët skulpturë dhe specialitetet: 3–4 nxënës për grup.

Dega "Balet":

i. Mësuesit e specialiteteve të baletit: 20 orë në javë.

ii. Mësuesit e lëndëve pianist shoqërues dhe piano sekondare: 20 orë në javë.

iii. Lënda e baletit klasik zhvillohet e ndarë vajza/djem, pavarësisht numrit.".

e) Fjalia e fundit e shkronjës "C" në kreun IV ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Nëndrejtori/nëndrejtorët ngarkohen për amzën, inventarin e shkollës dhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar në shkollë, kur shkolla nuk ka sekretar.".

ë) Pika 21 e kreut V ndryshohet me këtë përmbajtje:

"Mësuesit që jep lëndën e TIK/informatikës apo nëndrejtorit të shkollës, të ngarkuar si administratorë të shkollës për SMIP, u ulet norma me 2 orë mësimore në javë.".

f) Pas pikës 26 të kreut V të shtohen pikat 27 dhe 28 me përmbajtje si vijon:

"27. Mësuesit mbikëqyrës të Maturës Shtetërore i ulet norma me 2 orë mësimore në javë.

28. Mësuesit mbikëqyrës të Maturës Shtetërore, në gjimnazin e caktuar nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, të ngarkuar për hedhjen e notave të të gjitha viteve të kandidatëve me diplomë të shkollës së mesme të fituar jashtë shtetit dhe të njësuar në Shqipëri, i ulet norma me 2 orë mësimore në javë.".

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi